

Pranimi / Dorezimi / Prilazje / Prilazje / Received / Delivery		13. 04 2021		viti / god / year	1
Organ / Shënia / Organ / Shënia / Org / Unit	Nr. Prot / Nr. Prot / Prot. No	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity		
SKOMBACK	1748/2021		115		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.228/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi- dhe Eshref Shabani anëtarë si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2206/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.280/2019 të datës 16.05.2019 të parashtruar nga ankuesja

me adresë, rruga "Ahmet Selaci" në Komunën e Mitrovicës, kundër Vendimit me Nr. Prot:01-111/01-0029817-2/19 të datës 18.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.280/2019 e datës 16.05.2019 e parashtruar nga ankuesja**

**II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. Prot:01-111/01-0029817-2/19 i datës 18.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut.**

**A r s y e t i m**

Komuna e Mitrovicës së Jugut në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 07.02.2019, me datë 08.02.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për Produkte Ushqimore Jo shtazore", në këtë konkurs



ka aplikuar edhe ankuesja e cili është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë). Komuna e Mitrovicës së Jugut pas përfundimit të procedurës për pozitën e lartcekur, më datë 12.03.2019 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm ku ankuesja nuk është kandidat i suksesshëm, dhe kundër këtij njoftimi më datë 10.04.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut më datë 19.04.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:01-111/01-0029817-2/19 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. Prot:01-111/01-0029817-2/19 të datës 19.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 2323/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.05.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut. Komuna e Mitrovicës së Jugut më datë 29.05.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuara.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 21.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke inicuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2206/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 16.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2323/2019 të datës 16.05.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:01-111/01-0029817-2/19 të datës 19.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut; Diplomën me Nr. 611 të datës 23.08.2012 të ankueses; Vërtetimin e datës 21.09.2015, 19.03.2012 dhe 04.06.2015 të lëshuar nga Komuna e



Mitrovicës për ankuesen; Vërtetimin e datës 22.06.2001 të lëshuar nga Kooperativa Bujqësore "AGROKULTURA" për ankuesen; Certifikatën e datës 11.12.2018; Ankesën e datës 10.04.2019 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut; Konkursin e datës 08.02.2019 të shpallur nga Komuna e Mitrovicës së Jugut për pozitën "Zyrtar për Produkte Ushqimore Jo shtazore"; Autorizimi i DASHC/MAP i datës 07.02.2019; Deklaratën e datës 25.02.2019; Vendimin e datës 25.02.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Formularin për regjistrin e aplikacioneve të pranuara; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listë të ngushtë datë 27.02.2019; Raporti për përcaktimin e listës së shkurtër i datës 27.02.2019; Formulari Form.MAP-SHCK-07 për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formulari për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formulari për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues; Vendimi i datës 12.03.2019; Procesverbali i datës 15.04.2019 dhe 18.04.2019 i Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Fletë dorëzimi i datës 23.04.2019 Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 12.03.2019; Formularin Form.MAP-SHCK-06 për njoftimin e kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë; E-mailin e datës 28.02.2019 dhe 08.03.2019 për ankuesen nga

Testin me shkrim i datës 05.03.2019; Formularët Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe; E-mailin e datës 28.02.2019 dhe 08.03.2019 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Kërkesën për punësim të ankueses dhe kandidatës së suksesshme së bashku me dëshmitë e përvojës së punës dhe të përgatitjes profesionale dhe Përgjigjen në ankesë e datës 01.04.2019; Aktgjykimin A.nr.2206/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 21.08.2019 për ankuesen.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses \_\_\_\_\_ është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që kjo shpallje e konkursit nuk figuron në portal pune ëëë.portalpune.com; Procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që kjo shpallje e konkursit nuk figuron në portal pune www.portalpune.com, ka konstatuar që konkursi për pozitën "Zyrtar për Produkte Ushqimore Jo shtazore" ka qenë i publikuar në WEB faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut më datë 08.02.2019, po ashtu i njëjti konkurs është shpallur edhe në gazetën ditore "ZËRI" po më të njëjtën datë, mirëpo nuk është asnjë obligim ligjor që konkurset të shpallen në portale private, obligative është që konkursi të shpallet në faqen e institucionit, në këtë rast Komuna e Mitrovicës së Jugut me rastin e shpalljes së konkursit në web faqen e komunës dhe në gazetën ditorë, ka vepruar në pajtim me nenin 17 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Institucioni përkatës siguron që: Shpallja e rekrutimit duhet të bëhet në faqen e portalit qeveritar dhe të institucionit përkatës", rrjedhimisht pretendimi i ankueses është i pabazuar.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ka konstatuar që kriteret e konkursit për pozitën "Zyrtar për Produkte Ushqimore Jo shtazore" kanë qenë: *"Diplomë Universitare në Drejtimin e Teknologjisë Ushqimore ose Bujqësi. Minimum 2 (dy) vite përvojë pune profesionale"*, ndërsa në bazë të provave të lëndës respektivisht dokumentacionit të ankueses dhe kandidatës së përzgjedhur, është konstatuar që ankuesja dhe kandidatja e përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e konkursit, me çka nënkuptohet se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes së tyre në listën e shkurtër ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimin dhe kualifikimin profesional dhe përvoja e punës"*, rrjedhimisht nuk është kontestuese përvoja e punës së ankueses, mbi këtë bazë dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil gjegjësisht neni 28 paragrafi 2 përcakton se secili anëtar i komisionit vlerëson kandidatin në secilin kriter, ndërsa numri maksimal për secilin kriter është 20 pikë, kështu që në bazë të formularit për përcaktimin e listës së shkurtër ankuesja është vlerësuar tek arsimimi dhe kualifikimi profesional me 20 pikë, po ashtu me 20 pikë është vlerësuar edhe tek përvoja e punës, po ashtu edhe kandidatja e përzgjedhur për të dy fushat është vlerësuar me pikë të njëjta, në këtë rast nëse kandidatët plotësojnë këto kriterë vlerësohen me pikë maksimale (nga 20).

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që në konkursin për pozitën "Zyrtar për Produkte Ushqimore Jo shtazore", i është dhënë mundësia e barabartë të gjithë kandidatëve të cilët kanë aplikuar duke u respektuar neni 3 paragrafi 9 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe neni 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, po ashtu në fund të konkursit është përcaktuar që *"Ligji i Shërbimit Civil ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore si dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovës"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil vlerësimin e testit me shkrim dhe me gojë e ka bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi, kështu që në bazë të Formularit të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 72.1% të pikëve, ndërsa ankuesja është vlerësuar me 62.0% të pikëve, mbi këtë bazë në shërbimin emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u*



ankuar në fund të procedurës" dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, mbi këtë bazë pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot:01-111/01-0029817-2/19 të datës 19.04.2019, ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me legjislacionin në fuqi sepse ka shqyrtuar drejtë ankesën e ankueses duke vendosur në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.2206/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.228/2021, datë 13/04/2021

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet;**

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

